



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	16. 03 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRM/STK	1190/2021		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.51/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtar, dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.51/2021 të datës 02.02.2021, të parashtruar nga ankuesja nga Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike “Kompensim Material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.51/2021 e datës 02.02.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 02.02.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar më nr. 420/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.02.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës më datë 04.03.2021 ka dërguar provat e kërkuara.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 420/2021 të datës 02.02.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Raporti i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë lidhur me vijueshmërinë për muajin dhjetor të vitit 2020; Vërtetimi i datës 04.02.2021 me numër të protokollit lidhur me punësimin e ankueses në Policinë e Kosovës; Kërkesa e datës



21.01.2021: Vendimi i datës 18.01.2021 me numër te protokollit 03/02-23; Kërkesa për përgjigje ne ankese e datës 08.02.2021 me numër te protokollit 541/2021; Përgjigja ne ankese e datës 04.03.2021 me numër te protokollit 987/2021; Emali i datës 18.02.2021; Kontrata e punës me numër Nr. 0381; Formulari- PDP, përshkrimi i detyrave te punës; Kërkesa e datës 14.11.2020 me numër 318-KA-2020; Emali i datës 26.02.2021; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Janar i vitit 2021; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Nëntor të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Tetor të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Shtator të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Gusht të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Korrik të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Qershor të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Maj të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Prill të vitit 2020; Lista lidhur me vijueshmërinë në punë për periudhën kohore muaji Mars të vitit 2020; Vendimi i Qeverise se Republikës se Kosovës datës 25.09.2020 me Nr.02/32; Vendimi i Qeverise se Republikës se Kosovës datës 24.12.2020 me Nr.02/52; Kartela e nëpunësve civile për periudhën kohore muaji Janar deri në Dhjetor të vitit 2020; Emali i datës 18.02.2021; Emali i datës 09.02.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja ka themeluar marrëdhënien e punës sipas kontratës me numër 0381 te datës 19.07.2011 në pozitën "Pastruese", në Policinë e Kosovës.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë*; 6. *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike dhe si rrjedhojë duke u bazuar ne përshkrimin e detyrave te punës te ankuesit, Kolegji ka konstatuar se pozita "pastruese" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës respektivisht ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesja ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur

03/02-23



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.51/2021 e datës 02.02.2021 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas nenit 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtaret publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Komisioni i Ankesave në Policinë e Kosovës, përmes vendimit me numër të protokollit 03/02-23 të datës 18.01.2021 është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit dhe ka udhëzuar palën në ushtrimin e mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në rrethanat si me lartë, vlerëson se Komisioni i Ankesave në Policinë e Kosovës gabimisht ka udhëzuar palën lidhur me te drejtë e ushtrimit të mjeteve juridike, sepse kompetent për shqyrtimin e ankesës është Komisioni i Ankesave në kuadër të organit të punësimit ashtu siç përcaktohet me nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.51/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK- së;

